



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenit 13 të Ligjit për vetëqeverisje lokale nr.03/L-040, nenit 16 të Statutit të Komunës së Podujevës nr.prot.01-020/01-0050862/18, Rregulloren (QRK) 13/2017 për Riintegrimin e Personave të Riatdhesuar, në pajtim me Strategjinë Shtetërore për ri-integrim të qëndrueshëm të personave të riatdhesuar në Kosovë 2018/2020, dhe sipas Shkresës zyrtare nr.02-572/1 të datës 28.05.2019 të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal - MAPL, Kryetari i Komunës, nxjerrë,

VENDIM PËR NGRITJEN E GRUPIT PUNUES

Neni 1

Për hartimin e Planit Komunal për Riintegrim të Qëndrueshëm të personave të riatdhesuar 2019/2022 në Komunën e Podujevës, ngritët Grupi Punues, në këtë përbërje;

- | | |
|--|----------|
| 1. Nexhmi Rudari , <i>Nënkryetar i Komunës</i> , | kryesues |
| 2. Liman Zeqiri , <i>shef i Zyrës Komunale për Komunitete dhe Kthim</i> , | anëtar |
| 3. Ylber Salihu , <i>zyrtar për integrime evropiane</i> , | anëtar |
| 4. Arzie Potera , <i>zyrtare në Entin e Punësimit</i> , | anëtare |
| 5. Ardian Emini , <i>Drejtorja e Arsimit</i> , | anëtar |
| 6. Arbresha Bashota , <i>Drejtorja e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale</i> , | anëtare |
| 7. Naim Potoku , <i>Qendra për Punë Sociale</i> , | anëtar |
| 8. Naime Ajeti , <i>Drejtorja e Shërbimeve Publike Mbrojtës dhe Shpëtimit</i> , | anëtare |
| 9. Doruntina Sollova , <i>Drejtorja e Planifikimit Urban dhe Mbrojtës së Mjedisit</i> , | anëtare |
| 10. Labinot Murati , <i>Drejtorja e Pronës Kadastrit dhe Gjeodezisë</i> , | anëtar |

Neni 2

Grupit Punues sipas këtij Vendimi, harton Planin Komunal për Riintegrim të Qëndrueshëm të personave të riatdhesuar për periudhën 2019/2022 në Komunën e Podujevës, në përputhje me Planin e Veprimit për Strategjinë Shtetërore për Riintegrim të Qëndrueshëm të personave të riatdhesuar në Kosovë 2018 – 2020, Objektivi strategjik 4, Objektivi specifik 4.5, dhe Planin Kombëtar për Zbatimin e MSA-së për vitin 2019, si dhe dispozitave përkatëse ligjore dhe nënligjore.

Neni 3

Grupi punues për punët dhe aktivitet e zhvilluara, në formë të shkruar e informon Kryetarin e Komunës.

Neni 4

Ky Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Me këtë vendim njoftohen:

-Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal - MAPL
-Anëtarët e Grupit punues

Nr.prot.02-020/04-0072231/19
Podujevë, 05 shtator 2019





Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenin 13 dhe 58 shkronja b) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-040, nenet 16 dhe 61 parag.1.2 të Statutit të Komunës së Podujevës nr. 01-020/01-0050862/18, në pajtim me nenin 12 të Rregullores MF – Nr. – 04/2017 mbi kriteret standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve, nxjerr:

VENDIM

PËR SHPALLJEN E THIRRJES PUBLIKE PËR MBËSHTETJE FINANCIARE PUBLIKE OJQ-KLUBET SPORTIVE NË KOMUNËN E PODUJEVËS NË FUSHËN E AKTIVITETEVE SPORTIVE

Neni 1

- 1.Për implementimin e thirrjes publike do të zbatohen dispozitat e Rregullores mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve.
- 2.Mbështetja financiare publike e OJQ-Klubeve sportive në Komunën e Podujevës, në fushën e aktiviteteve sportive ofrohet nga Buxheti i Komunës së Podujevës, kodit ekonomik 21200, në kuadër të programit/nënprogramit 85005.

Neni 2

Mjetet financiare shpërndahen në bazë të thirrjes publike për financimin e projekteve të OJQ-ve, sipas vlerësimit dhe përzgjedhjes nga ana e komisionit si dhe dokumentacionit për zbatimin e thirrjes, e cila është pjesë përbërëse e këtij vendimi.

Neni 3

1. Dokumentacioni për zbatimin e thirrjes sipas pikës II të këtij vendimi përfshinë:
 - 1.1. Teksti i thirrjes publike
 - 1.2. Udhëzimet për aplikantët
 - 1.3. Formularët e aplikimit
2. Formularët e aplikimit referuar në paragrafin 1 të këtij neni janë:
 - 2.1. Forma e përshkrimit të programit apo projektit
 - 2.2. Forma e buxhetit të programit apo projektit
 - 2.3. Forma e deklaramentit të mungesës së fondeve të dyfishta
 - 2.4. Deklarata e Partneritetit

Neni 4

Thirrja publike dhe dokumentacioni për zbatimin e thirrjes do të publikohen në mënyrë të plotë në faqen e internetit të Komunës së Podujevës <https://kk.rks-gov.net/podujeve/>.

Neni 5

1. Në përputhje me Rregulloren për kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik për OJQ-të dhe udhëzuesit për aplikantët, do të formohet Komisioni Vlerësues për hapjen dhe regjistrimin e aplikacioneve si dhe verifikimin e kushteve të përcaktuara të thirrjes publike.

2. Komisioni vlerësues do të bëjë vlerësimin e përmbajtjes së aplikacioneve të projekteve të pranuar që kanë përmbushur me sukses kushtet formale për të qenë pjesë e konkurrimit sipas paragrafit 1 të këtij neni.

3. Komisioni Vlerësues punët dhe detyrat do t'i ushtrojnë në përputhje me rregullat e parapara me Rregulloren për financimin publik të OJQ-ve dhe procedurën e përcaktuar në Udhëzimin për aplikuesit.

Neni 6

Zbatimin e vendimit e bën Drejtoria e Kulturës Rinisë dhe Sportit.

Neni 7

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Nr.02-030/03-0073466/19
Podujevë, 11 shtator 2019



Kryetari i Komunës
Agim Veliu



KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenin 58 shkronja b të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-040, nenin 61 paragrafi 1.2 të Statutit të Komunës nr. 01-02/01-0050862/18, nenet 8 dhe 15 të Rregullores për caktimin e kritereve për ndarje të mjeteve buxhetore nga kategoria ekonomike subvencione dhe transfere, nr.01/111-400, Rregulloren për ndryshimin e Rregullores për caktimin e kritereve për ndarjen e mjeteve buxhetore nga kategoria ekonomike subvencione dhe transfere nr. 01/172-400 dhe Vendimin për miratimin e projektbuxhetit të Komunës së Podujevës për vitin 2019 dhe parashikimet buxhetore 2020-2021 nr.01-400/03-0078667/18, dt. 26.09.2018, në rekomandim të Komisionit të ngritur me vendimin e Kryetarit të Komunës nr.02-020/04-0011787/19, për shqyrtimin e kërkesave për mbështetje dhe ofrim të ndihmave nga kategoria e mjeteve buxhetore subvencione dhe transfere, sipas Ftesës Publike nr.12-320/01-0030346/19, dt. 08.04.2019, merr:

VENDIM PËR NDARJEN E SHOQËRIVE TË BLETËVE FERMERËVE - BLETARËVE NË KOMUNËN E PODUJEVËS

Neni 1

1. Ndahen 1000 (njëmijë) Shoqëri Bletësh për 100 (njëqind) fermerë – bletarë përfitues nga Komuna e Podujevës, në projektin “Përkrahja me shoqëri bletësh”, në kuadër të Drejtorisë së Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural.
2. Projekti sipas ftesës publike, realizohet përmes formës së participimit dhe atë; Komuna e Podujevës subvencionon 70% të vlerës së projektit, ndërsa fermerët përfitues marrin pjesë me 30% të vlerës së projektit.

Neni 2

Subvencioni bëhet me qëllim të promovimit dhe zhvillimit të bletarisë në territorin e Komunës së Podujevës.

Neni 3

Lista e përfituesve sipas nenit 1 është pjesë përbërëse e këtij Vendimi.


Neni 4

Zbatimin e Vendimit e bën Drejtoria e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural në bashkëpunim me Drejtorinë e Buxhetit dhe Financave të cilat koordinojnë rreth aktiviteteve me fermerët përfitues me qëllim të implementimit të projektit.

Neni 5

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Nr. 02-320/01-0074264/19
Podujevë, 17 shtator 2019




Kryetari i Komunës
Agim Veliu



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KRYETARI I KOMUNËS

Në bazë të nenit 22 paragrafi 5 të Ligjit nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik, Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikës së Kosovës, dhe neneve 13, 58 shkronja b) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale 03/L-040, në kërkesë nr.13-104/02-0074813/19 të datës 18.09.2019, merr,

VENDIM

I

znj.Florije Besholli, Udhëheqëse e Sektorit për Inspektime në Drejtorinë e Inspeksionit, pezullohet nga vendi i punës, për shkak të kandidimit për Deputete në Kuvendin e Republikës së Kosovës në Zgjedhjet Qendrore të shpallura për 06 tetor 2019.

II

Pezullimi sipas nenit 1 të këtij Vendimi, bëhet për periudhën kohore nga data 18 shtator 2019 deri më 10 tetor 2019, përkatësisht 7 ditë para hapjes zyrtare të fushatës zgjedhore dhe 5 ditë pas mbylljes zyrtare të fushatës.

III

Për zbatimin e Vendimit dhe dispozitave tjera ligjore që ndërlidhen me këtë çështje, kujdeset Zyra e personelit.


IV

Vendimi hynë në fuqi ditën e nënshkrimit


I'u dërgohet:

Florije Beshollit,
Zyrës së personelit
Arkivës

Nr.02-104/02-0074940/19
Podujevë,
18 shtator 2019



Kryetari i Komunës
Agim Veliu



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenet 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040, Ligjin nr. 04/L-175 për Inspektoratin e Mjedisit Ujërave Natyrës Planifikimit Hapësinorë dhe Ndërtimit dhe nenin 16 të Statutit të Komunës, nr. 01-020/01-0050862/18, merr:

VENDIM PËR NGRITJEN E KOMISIONIT PËR SHQYRTIMIN E ANKESAVE

Neni 1

Ngritet Komisioni për shqyrtimin e ankesave në fushën e mbrojtjes së mjedisit, ujërave dhe natyrës si dhe në fushën e ndërtimit dhe planifikimit hapësinor në Komunën e Podujevës, në përbërje:

1. Eset Abdullahu, kryesues
2. Naxhije Haliti, anëtare
3. Enver Rrahimi, anëtar

Neni 2

Komisioni ka për obligim shqyrtimin e të gjitha ankesave ndaj vendimeve të Drejtorive të Komunës që kanë të bëjnë por pa u kufizuar me lejet komunale mjedisore, lejet ujore, të mbrojtjes së natyrës dhe lejet ndërtimore.

Neni 3

Mandati i Komisionit është një (1) vit.

Neni 4

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

*Vendimi u dërgohet:
Anëtarëve të Komisionit
Arkivit*

Nr.02-020/04-0076364/19
Podujevë, 24 shtator 2019



Kryetari i Komunës
Agim Veliu